



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 313/4 prot.

Tiranë, më 21.06.2018

VENDIM

Nr.66, datë 21.06.2018

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 78, DATË 10.04.2017, NË
INSTITUCIONIN BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 78, datë 10.04.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë e Tiranës dhe ish komuna, aktualisht njësi administrative në përbërje të saj, dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”,

KONSTATOVA SE:

Me Vendimin nr. 88, datë 04.09.2015, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia e Tiranës”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes tematike në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Tiranë. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 78, datë 10.04.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë e Tiranës dhe ish komuna, aktualisht njësi administrative në përbërje të saj, dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

2. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, në kuptim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

*për punonjësen ******, duhet të anulohet aktin e nxjerrë për emërim në detyrë, si dhe aktet e nxjerra në kuadër të ristrukturimit të Bashkisë Tiranë, me argumentin se janë akte absolutisht të pavlefshme, pasi janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në kushtet kur ajo është emëruar në një pozicion të shërbimit civil, duke mos respektuar procedurat e kërkuara nga ky ligj.*

*Për ndreqjen e kësaj parregullsie, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, duhet të anulohet aktin nr. 184, datë 05.03.2014 “Për emërim në detyrë” si dhe aktin nr. 17817 prot., datë 12.11.2015 “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, të nxjerra për punonjësen ******, me detyrë “Specialist në Zyrën e Këshillit Bashkiak”, në Bashkinë e Tiranës.*

Pozicioni i saj i punës, duhet të shpallet pozicion i lirë dhe njësia përgjegjëse duhet të plotësojë këtë pozicion pune nëpërmjet procedurës së konkurrimit, në përputhje me përcaktimet e ligjit për nëpunësin civil.

- 3. Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në lidhje me punonjësit, ******, ******, ******, ****** dhe ******, të cilët në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk plotësonin kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë, për pozicionin e punës ku ata ishin të emëruar, njësia përgjegjëse e Bashkisë së Tiranës, duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punës për këta punonjës.*

Pozicionet e tyre të punës, duhet të shpallen të lira dhe të plotësohen nëpërmjet procedurës së konkurrimit, në përputhje me përcaktimet e ligjit të shërbimit civil.

- 4. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit përkatës, të përfundojnë hartimin e përshkrimeve të reja të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, lidhjeve pjesë e këtij vendimi dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*

Njësia përgjegjëse e Bashkisë së Tiranës, të japë konfirmimin e saj, lidhur me përshkrimet e punës, për pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil, nëse ato janë të hartuara në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç parashikohet në pikën 19, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e

pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse përshkrimet e punës të miratuara nga nëpunësi civil për të cilin është hartuar përshkrimi i punës, eprori direkt i pozicionit përkatës të punës dhe nëpunësi i punësuar në pozicionin ekuivalent me pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm, të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë njësisë përgjegjëse.

- 5. Njësia përgjegjëse e Bashkisë së Tiranës duhet të drejtojë procesin lidhur me konfirmimin ose jo të nëpunësve ***** dhe *****, në përfundim të periudhës së provës, sipas orientimeve të lëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.*
- 6. Njësia përgjegjëse, në lidhje me pozicionin e punës “Arkivist-Protokoll”, në njësinë administrative përkatëse, të qartësojë raportin që ka ky pozicion me shërbimin civil dhe të materializohet shprehimisht në strukturën e institucionit. Në vijim, pasi të jetë përcaktuar natyra e marrëdhënieve të punës në lidhje me këtë pozicion, të vijohet me trajtimin e tij, sipas ligjit që rregullon këtë marrëdhënie pune.*
- 7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*

Me kalimin e afatit të lënë për zbatimin e detyrave për përmirësimin e situatës dhe kthimin e gjendjes së ligjshmërisë, Komisioneri, në zbatim të Vendimit Nr.8, datë 06.03.2018, të tij, me objekt “*verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 78, datë 10.04.2017*”, nisi verifikimin e procedurave administrative për zbatimin e këtij vendimi, në përfundim të të cilit vlerësoj se:

Në pikën 2 të vendimit të Komisionerit është kërkuar nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë që të anulohet aktin e nxjerrë për emërim në detyrë, si dhe aktet e nxjerra në kuadër të ristrukturimit të Bashkisë për punonjësen *****, me argumentin se janë akte absolutisht të pavlefshme, pasi janë nxjerrë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në analizë të akteve administrative që materializojnë zbatimin e kësaj pike të vendimit, konstatoj se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, me vendimin nr. 15250/1 prot., datë 25.04.2017, “*Vendim për lirim nga Shërbimi Civil*”, ka revokuar aktin e emërimit në detyrë të punonjësës *****, në pozicionin e punës “*Specialist në Sektorin e Bashkërendimit me Këshillin Bashkiak*” dhe ka vendosur lirin e saj nga

shërbimi civil. Me Urdhrin nr. 15250/2, datë 03.05.2017, “Për përfundimin e marrëdhënieve financiare”, kësaj punonjëse i është bërë edhe ndërprerja e marrëdhënieve financiare.

Në kushtet kur tashmë kishte hyrë në fuqi kodi i ri i procedurave administrative, në vend të termit revokim, njësia përgjegjëse duhej të kishte përdorur termin anulim. Megjithatë, gjykoj se ky gabim me karakter material nuk e cenon vlefshmërinë e veprimit administrativ, vendimit për lirim nga shërbimi civil të punonjëses *****. Referuar nenit 112 të Kodit të Procedurave Administrative, gabimet materiale apo pasaktësitë e dukshme të aktit mund të korrigjohen në çdo kohë nga organi publik.

Në zbatim të pikës 3 të vendimit të Komisionerit, në të cilën është kërkuar nga njësia përgjegjëse, që të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punës për punonjësit ***** , ***** , ***** , ***** dhe ***** , për shkak të mosplotësimit të kriterit të nivelit të diplomës së arsimit të lartë, për pozicionin e punës ku ishin emëruar, konstatoj se njësia përgjegjëse ka marrë marrë masat e mëposhtme:

1. Me vendimin nr. 15245/1 prot., datë 25.04.2017, është vendosur lirim nga shërbimi civil i punonjëses ***** dhe me urdhrin nr. 15245/2 prot., datë 03.05.2017 është bërë ndërprerja e marrëdhënies financiare.
2. Me vendimin nr. 15246/1 prot., datë 25.04.2017, është vendosur lirim nga shërbimi civil i punonjëses ***** dhe me urdhrin nr. 15246/2 prot., datë 03.05.2017 është bërë ndërprerja e marrëdhënies financiare.
3. Me vendimin nr. 15249/1 prot., datë 02.05.2017, është vendosur lirim nga shërbimi civil i punonjëses ***** dhe me urdhrin nr. 15249/2 prot., datë 03.05.2017 është bërë ndërprerja e marrëdhënies financiare.
4. Me vendimin nr. 15248/1 prot., datë 25.04.2017, është vendosur lirim nga shërbimi civil i punonjëses ***** dhe me urdhrin nr. 15248/2 prot., datë 03.05.2017 është bërë ndërprerja e marrëdhënies financiare.
5. Me vendimin nr. 15247/1 prot., datë 25.04.2017, është vendosur lirim nga shërbimi civil i punonjëses ***** dhe me urdhrin nr. 15247/2 prot., datë 03.05.2017 është bërë ndërprerja e marrëdhënies financiare.

Në pikën 4 të vendimit të Komisionerit është kërkuar nga njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, që në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit përkatës, të përfundojë hartimin e përkrahjeve të reja të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë verifikimit në subjekt, konstatoj se përshkrimet e punës janë hartuar sipas formatit standard të miratuar siç parashikohet në pikën 19, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Në pikën 5 të Vendimit paralajmërues të Komisionerit, i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse që të drejtojë procesin lidhur me konfirmimin ose jo të nëpunësve ***** dhe ***** , në përfundim të periudhës së provës.

Në zbatim të nenit 24 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të pikës 13, të Kreut VI, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Tiranë me aktin nr. 2314 prot., datë 19.01.2017, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit në përfundim të periudhës së provës për punonjësen ***** , bazuar në rezultatin e testimin në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në ASPA, vlerësimin e rezultateve në punë dhe mendimin me shkrim të nëpunësit civil më të vjetër.

Nga ana tjetër, vërej se punonjësj ***** , nuk e ka kryer trajnimin e detyrueshëm për periudhën e provës. Me shkresën nr. 470 prot., datë 24.05.2017, Bashkia Tiranë ka vënë në dijeni Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, se kjo punonjëse i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt:

*“1. Anullimin e vendimit (të eprorit direkt në përfundim të periudhës së provës) me nr. prot. 32416, datë 07.08.2017, për ‘Moskonfirmimin e ***** , në pozicionin e specialistit në Drejtorinë e Rinisë – kategoria IV-a.*

2. Kryerjen e rivlerësimit të periudhës së provës.

*3. Detyrimin e palës së paditur për dhënien e konfirmimit të ***** , në pozicionin e specialistit në Drejtorinë e Rinisë, kategoria IV-a.”*

Nga përmbajtja e shkresës së sipërcituar rezulton se, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me vendimin e datës 26.12.2017, ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë”. Kundrejt kësaj kërkesëpadie, Drejtoria Juridike në Institucionin e Bashkisë Tiranë ka paraqitur në gjykatë kërkesën ankimore nr. prot. 46927, datë 28.12.2017.

Në këto kushte, referuar nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon se:

“Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata”, vlerësoj se në këtë rast, nuk është e nevojshme investimi i mëtejshëm nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Në pikën 6 të Vendimit, të Komisionerit i është kërkuar njësisë përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, të qartësojë situatën në lidhje me pozicionin e punës “Arkivist Protokoll” pranë njësisë administrative në përbërje të saj, Nëse ky pozicion pune nuk do të konsiderohet pjesë e shërbimit civil, kjo duhet të reflektohet edhe në emërtesën e tij, të materializuar në përmbajtjen e strukturës dhe organikës së institucionit.

Nga këqyrja e disa prej organikave të njësive administrative, konstatoj se, njësia përgjegjëse e institucionit, pozicionin e punës “*Arkivist Protokoll*” pranë këtyre njësive, nuk e ka konsideruar si pjesë të shërbimit civil.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 78, datë 10.04.2017, “*Për miratimin e raporti përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë e Tiranës dhe ish komuna, aktualisht njësi administrative në përbërje të saj, dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*”, të Komisionerit, arrij në përfundimin se nga ana e njësive përgjegjëse janë zbatuar plotësisht rekomandimet e Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 78, datë 10.04.2017, “*Për miratimin e raporti përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë e Tiranës dhe ish komuna, aktualisht njësi administrative në përbërje të saj, dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësive përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Tiranë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 78, datë 10.04.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Tiranë dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA